

KESH sh.a HYRJE

31 AUG 2022

Nr. 4229 Prot.

KËRKESË

KËRKUES: Znj.
Nr.ID: ()
Adresa:
Email:
Cel:

DREJTUAR: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë
Adresa: Rr "Abdi Toptani", Tiranë

Korporates Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a.
Adresa: Blloku Vasil Shanto, Tiranë

OBJEKTI: **Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit**

BAZA LIGJORE: Ligji nr.119 dt. 18.09.2014 "Për të Drejtën e Informimit"
Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
Neni 10 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut
Neni 19 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike,

E nderuar Zj. Ministre,

I nderuar Z. Administrator

Referuar bazës ligjore të renditur në hyrje, Ju drejtohem me këtë kërkesë që të me informoni dhe të me vini në dispozicion dokumentacionin për sa më poshtë:

A. Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

1. Memorandumi i mirëkuptimit për bashkëpunim, lidhur me projektin e HEC Skavicë, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë "Bechtel International Inc.", nënshkruar më 3 tetor 2020, si dhe procedurat e ndjekura për nënshkrimin e tij

B. Nga KESH sh.a.

1. Në kontekstin e detyrave të dakordësuara në Shtojcën 1 të Kontratës së fazës së parë "Kontratë për shërbime teknike – projekti hidroenergjetik i Skavicës", të negociuar e të nënshkruar ndërmjet autoritetit kontraktues Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. dhe shoqërisë Bechtel Limited (Kontrata), miratuar me VKM nr.485 datë 30.07.2021, kërkojmë informacion dhe dokumentacion përkatës në lidhje me:

a. Statusin në të cilën ndodhet realizimi i etapave dhe dorëzimi i shërbimeve dhe produkteve sic janë listuar në Tabelen e pjesës "Plani i pagesës së parashikuar të etapave" të Shtojcës 2 të Kontratës (duke cilësuar për secilën etape dhe aktivitet nëse është në statusin: (i) Në proces; (ii) Dorëzuar produkti; (iii) Pranuar produkti).

- b. Në mënyrë të vecantë, kërkojmë informacion analitik për ecurinë e aktiviteteve të përcaktuara si etapat M 8.1 – M 8.19 për VNMS, etapa M3.3, M4.3, M 6.6, M 7.2, M 7.4, M 7.6, M 7.8, M 7.10, M 7.12, M 7.14, M 9.4, M 9.6, M 9.9, M 9.14, M 13.1.
- c. Dokumentacionin provues për sa kërkuar më sipër në (a) dhe (b) - Produktet e pranuar ose Raportprogreset mujore sipas përcaktimit në pjesën "Raportet" të Shtojcës 1 të Kontratës.
2. Te vendi i identifikuar për ndërtimin e digës së HEC Skavica, duket se janë kryer dhe/ose po kryhen punime infrastrukturore inxhinieriko-civile. Në lidhje me këtë kërkojmë të na informoni mbi:
- a. A janë këto punime në funksion të projektit HEC Skavica? Nëse po, ju lutemi të na informoni (i) nga kush po kryhen këto punime; (ii) në bazë të cilës leje ndërtimi janë kryer/po kryhen
- b. Të na vini në dispozicion kopjë të lejes së ndërtimit përkatëse nëse e dispononi, ose të përcillni këtë kërkesë tonën pranë autoritetit përkatës të zhvillimit për administrimin e informacionit për një leje të tillë (Agjencia e Zhvillimit të Territorit ose Njësia përkatëse e Qeverisjes Vendore).

Kjo kërkesë bazohet në dispozitat e vecanta për të drejtën e informimit të publikut për çështje mjedisore dhe në nenin 3 të ligjit të sipërpërmendur, i cili shprehet:

"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit."

Kopje e dokumenteve të sipërpermendura mund të na i dërgoni në adresën postare dhe elektronike si më poshtë:

Adresa.

Email:

Për çdo komunikim tjetër me qëllim orientimin dhe sqarimin e paqartësive, mund të na kontaktoni në adresën elektronike të mësipërme:

Duke mbetur në pritje të një përgjigjeje të shpejtë dhe pozitive nga ana Juaj, Ju falenderojmë për mirëkuptimin.

Me respekt,

Tiranë, më 30.08.2022